



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENTI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 515/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Agon Ramadani- Referues dhe Kimete Gashi- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) OE "VB Tofaj" – Junik, Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i stadiumit të qytetit në Gjakovë, kontratë dy vjeçare", me nr. prok: 632-22-5416-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - Komuna Gjakovë me datën 08.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Aprovohet si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "VB TOFAJ" SH.P.K. me seli në Junik, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 06.10.2022 (me numër protokolli 515/2022) për aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i stadiumit të qytetit në Gjakovë-kontratë dy vjeçare " me nr. të prokurimit: 632-22-5416-5-1-1, iniciuar Komuna Gjakovë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK)

Anulohet, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit "Ndërtimi i stadiumit të qytetit në Gjakovë-kontratë dy vjeçare" me nr. të prokurimit: 632-22-5416-5-1-1, iniciuar Komuna Gjakovë, ndërkaq aktiviteti i prokurimit me të dhënat si më sipër kthehet në **rivlerësim**.

Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHP, për gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi. Në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për

mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).

Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues, “VB TOFAJ” SH.P.K.” me seli në Junik aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 06.10.2022, ka pranuar ankesë nga OE “VB. TOFAJ” SH.P.K me seli në Junik për aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i stadiumit të qytetit në Gjakove- kontrate dy vjeçare” me numër të prokurimit: 632-22-5416-5-1-1 dhe numër të brendshëm 632-22-037-511, iniciuar nga AK Komuna e Gjakovës, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 515/2022.

Për aktivitetin prokurimit në fjalë autoriteti kontraktues me datën 12.09.2022 ka publikuar B58-Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues (Njoftim për anulim të aktiviteti të prokurimit) dhe Letrat Standarde.

OE “VB. TOFAJ” SH.P.K. me seli në Junik, me datën 22.09.2022, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Autoritetin kontraktues me datën 26.09.2022, e njofton OE ankues se kërkesa e tyre nuk do të shqyrtohet sepse e njëjta kërkesë është e jashtëafatshme.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Me datën 08. 11. 2022 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, i cili me datën 14 tetor 2022, ka konstatuar se:

Autoriteti Kontraktues – Komuna Gjakove, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është pune me vlerë të madhe. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit të OE “VB TOFAJ” shpk – Junik, (me teje si parashtruesi i ankesës), ku AK – Komuna Gjakove, përmes letrës standarde të datës 12.09.2022, tekstualisht ka potencuar: “Ju si OE nuk keni ofruar dëshmi të mjaftueshme se keni përfunduar me sukses kontrata të natyrës se ngjashme (rikonstruim, ndërtim apo renovim të stadioneve) në tre vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontrate...”

Përgjigjeje në pretendimin ankimore (neni 113): Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lendes kundrejt pretendimeve ankimore dhe arsyetimit të eliminimit sqarojmë se AK- Komuna Gjakove, kundrejt kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional, përveç tjerash në pozicionin 1, si dëshmi dokumentare ka kërkuar; “Lista e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha punët e realizuara në 3 (tri) vitet e shkuara, duke saktësuar punët e kryera shumë e kontratës, datën e pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit të mirë të punëve – (referencë ose raport të pranimi të punëve e cila përputhet me listën e dorëzuar), në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca me Operator Ekonomik privat atëherë Operatori Ekonomik duhet të prezanton situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhen me të njëjtën kontratë-referencë”.

Po ti referohemi objektit të kontratës – procedurës së prokurimit, kërkesës së AK-se dhe projekteve të prezantuara në oferte, rezulton që parashtruesi i ankese ka prezantuar dëshmi të mjaftueshme përmes të cilave mbulohet vlera dhe kërkesa. Sipas para masës dhe para llogarisë, natyra e aktivitetit të prokurimit, ka të bëjë me:

- Pune parapërgatitore
- Pune të dheut dhe zhavorrit
- Punët e betonit dhe
- Punët e konstruksionit metalik

Pra parashtruesi i ankësës së bashku me anëtarët e grupit – konzorciumit, kanë prezantuar dëshmi të mjaftueshme përmes të cilave mbulohen kjo kërkesë e kualifikimit. Si prova shkresore së bashku me këtë raport do prezantojmë provat shkresore – listën e projekteve të realizuara paraprakisht.

Parashtruesi i ankësës, ka ngritur pretendime ankimore edhe kundrejt ofertës tjetër, e cila tani me është eliminuar nga AK – Komuna Gjakove, me arsyetimin se i njëjti ka ofertuar me oferte financiare – gabime aritmetike të cilat e kalojnë vlerën prej me shumë se 2%, pra edhe OE “Naim Sopaj” BI, i njëjte është pajtuar me gabimet e tilla përderisa nuk e ka kontestuar. Përveç kësaj parashtruesi i ankësës ka ngritur edhe pretendime tjera kundrejt të njëjtës oferte, përkatësisht kundër kërkesave të kapacitetit ekonomik financiar dhe kapaciteti teknik dhe profesional.

Sa i përket pretendimeve ankimore kundrejt ofertës së OE “Naim Sopaj” BI tani me të eliminuar nga AK, lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare, sqarojmë që AK – Komuna Gjakove, përmes kërkesës ka kërkuar: Deklarata nga banka që vërteton disponueshmërinë e 300.000,00€ në llogarinë bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të marrë kredi prej 500.000,00€, nëse është e nevojshme. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë. Këtë pretendim ankimor e kualifikojmë si të pa bazuar pasi që Banka Raiffeisen ka

dhëne letër mbështetje me vlerë të përcaktuar për operatorin ekonomik pikërisht për këtë aktivitet të prokurimit.

Edhe pretendimin tjerë ankimore, kundrejt deklaratës nën betim të njëjtit OE e kualifikojmë si të pa bazuar pasi që deklarata është e nënshkruar vulosur dhe i përmban të dhënat e kompanisë. Po ashtu edhe me raportet e audituara, nga kompani e licencuar, përfshirë edhe pretendimin ankimore lidhur me identifikimin financiar, sqarojmë se e njëjta kërkesë është aplikuar tek kërkesat e kapacitetit ekonomik dhe financiar, gjë qëllimi i krijimit të grupit – konzorciumit sipas nenit 71, të LPP-se, par 4 potencon "...Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit", prandaj edhe këtë pretendim ankimore e kualifikojmë si të pa bazuar. Pra nuk është kërkesë obligatore ndaj të anëtarëve të grupit si tërësi kjo kërkesë e kualifikimit siç pretendon parashtruesi i ankesës.

Pikat tjetër ankimore është edhe ajo se pjesa dërmuese stafi të kompanisë tani me të eliminuar nga AK – Komuna Gjakovë, që nga muaji mars i vitit 2022, nuk janë në marrëdhënie pune.

Për këtë qeshje AK – komuna Gjakovë, nuk ka kërkuar nga ofertuesit potencial që stafi të jete i punësuar në baza mujore por është kërkuar lista me se paku 50 punëtorë, dhe dëshmi dokumentare kontrate apo para kontratë, prandaj edhe këtë pretendim ankimore e kualifikojmë si të pa bazuar pasi që grupi i OE ve tani me të eliminuar ka prezantuar listën e stafit nga grupi i anëtarëve përmes të cilave mbulohet numri i kërkuar.

Pretendimi i fundit ankimore ka të bëjë me pretendimin tjetër ankimore lidhur me stafin profesional, ku grupi i OE NNP Sopi – Prizren, sa i përket stafit profesional, ka prezantuar kopjet e diplomave VC si dhe diplomat e noterizuara, përjashtojë inxhinierin e gjeodezisë ku AK – Komuna Gjakovë, përmes kërkesës së kualifikimit ka kërkuar edhe licence për gjeodetin përderisa grupi i OE "Roza Komani" sipas ofertës ka prezantuar teknik të gjeodezisë me kualifikim të mesëm shkollorë, rrjedhimisht nuk është prezantuar licence e gjeodetit.

Po ashtu AK- Komuna Gjakovë, kundrejt stafit të kualifikuar si dëshmi dokumentare ka kërkuar "Kontratën e punës apo para kontratën e noterizuar nga noteri me vërtetim të nënshkrimit". OE të cilin e konteston ankuesi kundrejt stafit ka prezantuar kryesisht kopje të noterizuara dhe jo vërtetim të nënshkrimit, edhe pse për një pjesë të stafit janë prezantuar lista e punëtorëve nga ATK.

Si përfundim, bazuar në atë që u përshkrua si më lartë, vlerësimi ynë është se vlerësimi i ofertave nuk është bërë në harmoni me kërkesat kundrejt ofertave, përkatësisht në harmoni me nenin 59, të LPP-se.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues "VB Tofaj", të aprovohet si e bazuar.

Te anulohet propozimi - njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit dhe lënda te kthehet ne ri vlerësim.

- Seanca dëgjimore-

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe analizimit të të gjitha provave të lëndës, konstatoj se seanca dëgjimore mund të mbahet pa prezencën e palëve konform nenit 24 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020.

Paneli Shqyrtues ankesën e OE ankues e klasifikon si të bazuara dhe e mbështetet raportin e përpiluar nga eksperti shqyrtues i prokurimit, i cili është caktuar nga OSHP, detyrë e të cilit ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe propozimi i tij për panelin shqyrtues është që ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar, dhe në përputhje me LPP-në, rekomandon autoritetin kontraktues të anulohet propozimi - njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit dhe lënda te kthehet ne ri vlerësim. Kështu që, edhe arsyetimet e dhëna nga ekspertët shqyrtues në raportin ekspertizës llogariten si arsyetime të panelit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkalles se pare, Departamentit Administrativ në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.


Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vëdat POTERQOI

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK-së
- 1x1 OE ankues
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.